



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1203/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Ardiana Bejtullahu kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Podujevë nga radhët e koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), paraqitur për shkak të parregullsive dhe të mungesës të votave për zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Ardiana Bejtullahut kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Podujevë nga koalicioni AAK-LDD.

Arsyetim

PZAP-i, më datën 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Ardiana Bejtullahu kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Podujevë nga radhët e koalicionit AAK-LDD, për shkak të parregullsive në vendvotimet Lluzhan në dy vendvotime 1803E; Llapashtic e Eperme 1810E ne 2 vendvotime: Doberdol 1813E dhe 1831E ne 2 vendvotime; Dumnic ne 2 vendvotime.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP ka konstatuar se ankesa e tillë është si e përgjithshme dhe e pa bazë pasi që parashtruesi i ankesës në ankesën e saj nuk ka specifikuar se cilat janë parregullsitë apo shkeljet për të cilat ajo do të pretendonte në ankesën e saj andaj mbi këtë bazë PZAP-i konsideron se një ankesë e tillë është e pabazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 1203/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.